



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE
KLINIKA STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2026

Lënda: Shpallje e vëndit vakant në pozicionin Magazinier.

Drejtuar : Agjensisë së Prokurimit Publik

Në zbatim të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 'Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar, VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006 'Për botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike', Urdhërit Nr.624 datë, 05.12.2024 “Për Miratimin e Organikës së Klinikës Stomatologjike Universitare”, si dhe për nevojat e institucionit kërkojmë njoftimin për vëndin e lirë të punës si më poshtë:

Klinika Stomatologjike Universitare njofton shpalljen e vëndit vakant në pozicionin

Magazinier/e . Personat e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:

- Të kenë përfunduar arsimin e mesëm.
- Të zotërojnë aftësi të nevojshme profesionale.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 3 (tre) vite pune në punën përkatëse .

Detyrat e punonjësit të Magazinës :

1. Ka varësi direkt nga drejtori për problemet e furnizimit të shpërndarjes dhe problemet financiare ka varësi direkte nga Financa
2. Njeh ligjësitë për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin e vlerave materiale e monetare që disponon në magazine
3. Jep informacion mbi gjendjen e vazhdueshme të mallrave në magazine .
4. Miremban të gjithë mallin që ka të magazinuar
5. Shpërndan mallrat vetëm me urdher-dorëzim nga personat që janë autorizuar.
6. Plotëson sipas rregullit dokumentacionin e flete-hyrjes dhe flete-daljes me të gjitha ekstremet që ka dokumenti
7. Kontrollon dhe përgjigjet për afatet e përdorimit të mallrave dhe bën shpërndarjen e tyre duke respektuar kohën e furnizimit.
8. Vëndos etiketat me çmimin dhe skadencën e mallrave që hyjnë në magazine.

9. Rakordon me zyren e finances ne cdo fund muaji per levizjen kontabel te mallrave.

10. Pergjigjet materialisht per te gjithë mallin qe disponon ne magazine

Kandidatet e interesuar duhet te dorezojne prane zyrës së protokollit keto dokumenta si me poshte:

Dëshmi Penaliteti.

Kërkesë me shkrim për aplikim për punë.

Jetëshkrim sipas formatit standart

Fotokopje të noterizuar të listes së notave.

Fotokopje e letërnjoftimit (ID).

Vërtetimin e gjendjes shëndetësore dhe për aftësinë për punë (nga KML).

Rekomandime, në rast se ka, mundësisht nga punëdhënësi i fundit

Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë ,aftësitë,kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme.

Dorëzimi i dokumentacionit:

Te gjitha dokumentat duhet te jene te noterizuara brenda 6-mujorit te fundit.

Dokumentet mund të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të njësuara sipas ligjit.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

Dokumentet dorëzohen pranë Zyrës së Protokollit të KSU, në adresën:

Rr. Dibra, QSUNT, Tiranë. Afati i dorëzimit 7 dite kalendarike nga dita e publikimit te njoftimit.

Për çdo paqartësi mund të dërgohet e-mail në adresën KSU@shendetesia.gov.al

